


## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.07.2017, mori:

### V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-394/17, për z. Parim Kosova, Kryesues i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm të gjendjes së konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Parim Kosova, Kryesues i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe njëkohësisht bashkëpunëtor profesional në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas pranimit të informatës me pretendime për konflikt interesi, zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës është organizuar një takim me zyrtarin e lartë për të marrë informacione lidhur me rastin. Ligji nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në nenin 18 (paragrafi 2,5) përcakton se "Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale, afariste si dhe me aftësi të tjera praktike. Asnjë nga anëtarët e emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta aktuale me institucionin në të cilin emërohet".

*“Këshilli drejtues për çdo vit zgjedh kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin prej anëtarëve të vet, të cilët nuk janë punonjës apo studentë të institucionit”.*

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nt.04/L-051 në nenin 10 (paragrafi 2) ka përcaktuar se *“gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera”.*

Ushtrimi i funksionit Kryesues i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe njëkohësisht bashkëpunëtor profesional në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren nuk paraqet konflikt interesi sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

